FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.18	2004	31 mars

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
	Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë, datë 8.3.2004.....	913
Vendim i KM nr.128, datë 11.3.2004	Për disa ndryshime në vendimin nr.459, datë 23.9.1999 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet".....	914
Vendim i KM nr.129, datë 11.3.2004	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, për dëmshpërblimin e ish-punonjësve të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos në Fushë-Krujë	915
Vendim i KM nr.134, datë 11.3.2004	Për transferimin në pronësi bashkisë së qytetit të Rrëshenit të degës së mobilizimit, e cila është në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes"	916
Vendim i KM nr.143, datë 11.3.2004	Për anëtarësimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit në Komitetin Ndërkombëtar për Regjistrimin e Kafshëve (ICAR)…	916
Vendim i KM nr.146, datë 18.3.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.822, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave "Për shitjen me ankand të hotel "Tirana International"	917

Vendim i KM nr.151, datë 18.3.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.333, datë 29.5.2003 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit"	917
Vendim i KM nr.155, datë 18.3.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.594, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Marrëveshjes së koncesionit të formës "ROT", ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës e Ministrisë së Ekonomisë dhe Shoqërisë "Kurum Internacional"sh.p.k., Tiranë për fabrikën e oksigjenit në Elbasan".....	919
Vendim i KM nr.157, datë 18.3.2004	Për një shtesë në vendimin nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore".....	920
Vendim i KM nr.161, datë 18.3.2004	Për mënyrën e llogaritjes, të caktimit dhe pagesës së përfitimeve për punonjësit, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake	921
Vendim i KM nr.162, datë 18.3.2004	Për përdorimin dhe kontrollin e fondit për veprimtaritë specifike të Shërbimit Informativ Ushtarak.....	922
Vendim i KM nr.163, datë 18.3.2004	Për kriteret dhe masën e kompensimit të dëmeve shkaktuar pronës së punonjësit të Policisë Ushtarake, gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj.....	923
Vendim i KM nr.164, datë 18.3.2004	Për transferimin në pronësi të bashkisë së qytetit të Fushë-Krujës të mjediseve të degës së mobilizimit, të cilat janë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".....	924
Udhëzim i KM nr.2, datë 18.3.2004	Për procedurat e lëvizjes së objekteve të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta, kombëtare dhe unikale, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë	924
Udhëzim i KM nr.3, datë 18.3.2004	Për format dhe procedurat e identifikimit dhe të raportimit nga organet, që licencojnë personat fizikë dhe juridikë, në funksion të procesit të parandalimit të pastrimit të parave.....	925
Vendim i GJK nr.5, datë 11.3.2004	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.151/1, datë 31.1.2004 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë si i papajtueshëm me Kushtetutën	928
Vendim i GJK nr.6, datë 11.3.2004	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.326, datë 18.4.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr.90, datë 27.9.2001 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe nr.106, datë 8.2.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit), si të papajtueshme me Kushtetutën	929
	Vendim i shkurtuar për heqjen e zotësisë shtetases Aida Shehu .	936
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Viliam Kosturi.....	936
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Jani Qorri.....	936

REZOLUTË

Duke mbajtur parasysh interesat strategjikë të vendit dhe ata kombëtarë, të cilave u shërben integrimi europian dhe euroatlantik i Shqipërisë;

Duke vlerësuar rëndësinë historike që ka dhe ndihmesën që sjell ky proces për Shqipërinë, për shqiptarët në Kosovë, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbi e Mal i Zi dhe shqiptarët që jetojnë e punojnë në vendet e bashkësisë euroatlantike;

Duke e konsideruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit Shqipëri-BE, si një hap tjetër institucionalizues të procesit historik të integrimit tonë europian dhe njëherësh si mekanizëm, që çon përpara reformat modernizuese në çdo sektor dhe afron vendin me standardet e BE-së;

Duke njohur natyrën komplekse dhe rrjedhimisht gjithëpërfshirëse të këtij procesi, si dhe ndihmesën që jep e duhet të japë në ecurinë e tij dhe në interes të të gjithëve çdo institucion, çdo faktor i shoqërisë e deri çdo shtetas;

Duke iu referuar rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të muajit prill 2003, lidhur me procesin e negociatave për stabilizim-asociim;

Duke vlerësuar pozitivisht ecurinë e negociatave dhe veçanërisht progresin e arritur, që nga hapja e tyre e deri më sot, në të gjithë sektorët;

Duke konsideruar ndihmesat e dhëna në këtë proces, sipas natyrës dhe detyrimeve kushtetuese e ligjore, nga institucionet përkatëse legjislative dhe ekzekutive;

Duke bërë bilancin e efekteve pozitive të domosdoshme, të qëndrueshme e afatgjata të zbatimit të reformave, por edhe të problemeve sociale kalimtare që ato gjenerojnë në disa drejtime, si dhe të shqetësimeve që sjellin për kategori të caktuara të shoqërisë;

Duke vlerësuar pozitivisht si detyrimet në vazhdim dhe ato të pritshme, të gjitha kërkesat që burojnë natyrshëm nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, ashtu edhe mundësitë në rritje që jep vetë periudha kohore e domosdoshme për negociatat, nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, pas miratimit të saj dhe nga institucionet përkatëse të BE-së e të vendeve anëtare,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Nxit dhe mbështet Qeverinë e Republikës së Shqipërisë që të përfundojë negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit brenda këtij viti.

2. Ngarkon qeverinë që të vazhdojë zbatimin e të gjitha reformave që janë atribute të saj dhe që i shërbejnë drejtpërdrejt përmbushjes së kërkesave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Në këtë kuadër, ajo duhet të thellojë reformat në ekonomi, përfshirë privatizimet e mëtejshme të sektorëve strategjikë, të shtojë punën për aftësimin e administratës publike dhe decentralizimin, të vazhdojë vendosmërisht luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve dhe korrupsionit, të minimizojë ekonominë informale dhe evazionin fiskal, të shtojë mbledhjen e të ardhurave dhe të optimizojë përdorimin e fondeve publike.

3. Gjithashtu ngarkon qeverinë, që krahas thellimit të reformave për arritjen e standardeve të kërkuara nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, të vazhdojë të nxisë realizimin e zgjidhjeve për zbutjen e efekteve sociale të reformave, sidomos gjatë periudhës së përshtatjes me situatat e reja të ekonomisë së tregut, kur nisma e lirë dhe sektori privat janë përfundimisht faktorët kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit dhe kur, krahas efekteve pozitive të liberalizimit të këmbimeve ndërkombëtare, duhen përballuar edhe ndikimet negative.

4. T'u bëhet e njohur të gjithë faktorëve vendas, pa asnjë përjashtim, matrica e përgatitur nga qeveria, për kërkesat që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe masat e domosdoshme për përmbushjen e saj; gjithashtu qeveria, me shpjegimet përkatëse, të ndihmojë veçanërisht opinionin e gjerë publik me njohjen e kërkesave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, masat e domosdoshme për plotësimin e tyre dhe efektet përkatëse afatshkurtra dhe afatgjata që objektivisht sjell ky proces.

5. I kërkon qeverisë të vazhdojë intensivisht punën me Komisionin Europian dhe me qeveritë e vendeve anëtare dhe atyre të asociuara të BE-së, në shërbim të përfundimit me sukses dhe zbatimit të përbashkët të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit Shqipëri-BE.

6. Gjithashtu, i kërkon qeverisë të tregojë një vëmendje të veçantë për fuqizimin e kapaciteteve administrative të Ministrisë së Integrimit Europian dhe trajtimin e tyre financiar, si dhe fuqizimin e kompetencave të saj në raport me strukturat e integrimit pranë ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore.

7. U kërkon të gjitha institucioneve të tjera shtetërore, përfshirë edhe sistemin gjyqësor dhe prokurorinë, që të plotësojnë angazhimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe procesi i integrimit europian.

8. Fton të gjithë faktorët politikë dhe të shoqërisë civile, çdo shtetas të Republikës së Shqipërisë, që të vazhdojë të japë ndihmesën e vet të domosdoshme për mbarëvajtjen e gjithë procesit të Stabilizim-Asociimit të vendit tonë me BE-në.

9. Do të nxisë dhe do të mbështesë plotësimin e gjithë reformës së domosdoshme në shërbim të përafrimit gradual të legjislacionit shqiptar me atë komunitar.

10. Gjithashtu, nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve me parlamentet e vendeve anëtare dhe të asociuara të BE-së, si dhe me vetë Parlamentin Europian, të nxisë përfundimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit Shqipëri-BE dhe për të siguruar ratifikimin e saj në kohën më të afërt të mundshme.

Tiranë më, 8.3.2004

VENDIM
Nr.128, datë 11.3.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.459, DATË 23.9.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR PËR KULTET"

Në mbështetje të neneve 10 e 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin e funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.459, datë 23.9.1999 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet për të ndihmuar në krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare, që kanë objekt dhe ndjekin qëllime besimi dhe ndërgjegjje, sipas ligjit në Republikën e Shqipërisë.

Komiteti Shtetëror për Kultet është institucion qendror, person juridik në varësi të Kryeministrit.".

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Komiteti Shtetëror për Kultet përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë. Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet dhe anëtarët e këtij komiteti, të cilët propozohen nga kryetari, emërohen nga Kryeministri. Gjatë emërimit të përbërjes së Komitetit Shtetëror për Kultet, Kryeministri dhe kryetari i tij marrin parasysh dhe ruajnë parimet e asnjanësisë shtetërore dhe të barazisë së bashkësive fetare, si dhe faktin që struktura e komitetit të reflektojë, realisht, identitetin dhe vlerat e bashkësive fetare.

Struktura, organika dhe rregullorja e veprimtarisë së Komitetit Shtetëror për Kultet miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.".

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Pagat e nëpunësve të Komitetit Shtetëror për Kultet të jenë sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, ndërsa punonjësit e tjerë të paguhen sipas lidhjes II-5 të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

	Paga mujore			
Emërtimit	Paga individuale (Paga bazë)			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4
	Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
Kryetar	9 000	2%	0	90 000
Anëtar	9 000	2%	0	55 000
Specialist	9 000	2%	0	20 000

VENDIM
Nr.129, datë 11.3.2004

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2004, MIRATUAR PËR MINISTRINË E EKONOMISË, PËR DËMSHPËRBLIMIN E ISH-PUNONJËSVE TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇIMENTOS NË FUSHË-KRUJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës VI të nenit 3 të kontratës "Për shitjen e aseteve të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë-Krujë", miratuar me ligjin nr.8709, datë 6.12.2000, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t'i shtohet fondi prej 48 000 000 (dyzet e tetë milionë) lekësh, për një pjesë të dëmshpërblimit të papaguar për 978 ish-punonjësit e ndërmarrjes së prodhimit të çimentos në Fushë-Krujë, të larguar nga puna pas privatizimit të kësaj ndërmarrjeje.

2. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Shpërndarja e fondit të bëhet nga dega e bankës së kursimeve, Krujë, sipas listëpagesave të verifikuara nga eksperti kontabël i Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë.

4. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.134, datë 11.3.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI BASHKISË SË QYTETIT TË RRËSHENIT TË DEGËS SË MOBILIZIMIT, E CILA ËSHTË NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushetutës dhe të neneve 2 shkronja "c", 5,7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dega e mobilizimit në qytetin e Rrëshenit, e cila është në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, t'i kalojë në pronësi bashkisë së këtij qyteti, për sistemimin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve.
2. Prona me numër rendor 991, "Dega e mobilizimit" në Rrëshen, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
3. Bashkisë së qytetit të Rrëshenit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve, pa miratimin e pushtetit qëndror.
4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, drejtori i zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Rrëshenit të ndjekin procedurat e nevojshme për transferimin e kësaj prone.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.143, datë 11.3.2004

PËR ANËTARËSIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT NË KOMITETIN NDËRKOMBËTAR PËR REGJISTRIMIN E KAFSHËVE (ICAR)

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarësimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit në Komitetin Ndërkombëtar për Regjistrimin e Kafshëve (ICAR).
2. Kuota e anëtarësimit të përballohet nga buxheti i kësaj ministrie.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.146, datë 18.3.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.822, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHITJEN ME ANKAND TË HOTEL "TIRANA INTERNATIONAL""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, të Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.822, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim:

- Shkronja "a" e pikës 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Punonjësit e shoqërisë "DV-ALBTURIST HOTELIERS" sh.p.k., që do të dalin të papunë, si rrjedhojë e shitjes së objektit, t'u jepen si shpërblim përfundimtar, 12 paga mujore, duke marrë si bazë pagën mesatare të secilit për vitin 2003.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.151, datë 18.3.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.333, DATË 29.5.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.333, datë 29.5.2003 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në pikën 1, lidhja nr.1 "Niveli i pagës bazë për gradë, sipas roleve për punonjësit e Policisë së Shtetit", zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Në pikën 5, pas fjalëve "...e pagave të Ministrisë së Rendit Publik" të shtohen "...dhe vendimi nr.429, datë 11.6.2001 i Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të Policisë Gjyqësore", i ndryshuar...".

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 9980 mijë lekë, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministri i Rendit Publik dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16.2.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Niveli i pagës bazë për gradë, sipas roleve për punonjësit e Policisë së Shtetit Lidhja nr.1

Roli	Grada	Paga bazë (për gradë)	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi			
			Në funksione të policisë.....	Në funksione operuese N.shpejtë	Në funksione operuese F.speciale	Në funksione të forc.së posaçme dhe Of.Pol.Gjyq. pranë prokurorisë për krimet e rënda
1	2	3	4	5	6	7
Bazë	Agjent	24800	4000	7000	30000	
	Agjent i I-rë	25800	4000	7000	35000	
	Asistent	26800	4000	8000	42000	
	Asistent i I-rë	27800	4000	8000	44000	
	Kryeasistent	28800	4000	8000	44000	
I Mesëm	Nëninspektor	37000	4000	6000	38000	18500
	Inspektor	39000	4000	6000	38000	19500
	Kryeinspektor	44000	4000	6000	38000	22000
I Lartë	Nënkomisar	54000	4000	6000	31000	27000
	Komisar	67000	4000	6000	31000	33500
	Kryekomisar	77000	4000	6000	31000	
Madhor	Drejtues	87000	8000	10000		
	Zv/Drejtor i Përgjithshëm	103000	15000			
	Drejtor i Përgjithshëm	124500	20000			

VENDIM
Nr.155, datë 18.3.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.594, DATË 28.8.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS "ROT", NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRISË DHE ENERGJETIKËS E MINISTRISË SË EKONOMISË DHE SHOQËRISË "KURUM INTERNACIONAL" SHPK, TIRANË, PËR FABRIKËN E OKSIGJENIT NË ELBASAN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aneksi I i Marrëveshjes së koncesionit të formës "ROT", ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës e Ministrisë së Ekonomisë dhe shoqërisë "Kurum Internacional" sh.p.k., Tiranë, për fabrikën e oksigjenit në Elbasan, miratuar me vendimin nr.594, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave, ndryshon dhe zëvendësohet me aneksin I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës dhe Ministri i Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKSI I

Planimetria e fabrikës së oksigjenit Elbasan

Sipërfaqet kryesore:	
Sipërfaqja e përgjithshme	30 162,50 m^2
Sipërfaqe të lira	16 658,46 m^2
Rrugë e sheshe të asfaltuara	4 303 m^2
Sipërfaqja e përgjithshme e objekteve	9 201,04 m^2

Dimensionet e kufirit teknologjik të fabrikës të jepen në genplan

Kufizimet:

Nga veriu	Rrugë dhe tokë e papunuar
Nga jugu	Tokë e papunuar
Nga lindja	Përroi i Kushes
Nga perëndimi	Objekte të TEC-it

Fabrika e oksigjenit sh.a. (objektet)
1. Freskorja
2. Stacioni i pompave
3. Depo e perlitit
4. Magazina rikupero
5. Mensa
6. Depo e vajit
7. Godina e administratës
8. Ambiente të shërbimit mekanik
9. Reparti i bombolave

10. Dushe dhe garderoba
11. Tri sfera të depozitimit të oksigjenit
12. Stacioni i reduktimit
13. Dy kullat me kapacitet 3200 Nmk
14. Salla e kompresorëve
15. Nënstacioni
16. Ambiente pune
17. Linja e tubacioneve teknologjike
18. Linjat e tensionit që lidhen me sistemin e energjisë kombëtare
19. Shtesa e mbushjes së bombolave
20. Dhoma e dezhurnit dhe e zhveshjes

Shënim. Bashkëngjitur paraqesim genplanin e fabrikës për koncesion.

- Kullat 6800 Nmk i jepen në ruajtje firmës "Kurum International", për një periudhë 3-vjeçare. Në fund të kësaj periudhe firma "Kurum International" duhet të paraqesë planbiznesin për ristrukturimin e tyre, në të kundërt do t'i kthehen OSHA-së.

VENDIM
Nr.157, datë 18.3.2004

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.424, DATË 9.7.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE QË KRIJOJNË INSTITUCIONET BUXHETORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave të bëhet kjo shtesë:

-Në shkronjën "a" të pikës 1 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore dhe nga shitja e biletave të Teatrit Kombëtar, Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe Teatrit Kombëtar për Fëmijë, institucione këto kombëtare, buxhetore të kulturës dhe të artit, në varësi të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, t'u mbeten këtyre institucioneve, në masën 90 për qind, ndërsa 10 për qind të derdhen në Buxhetin e Shtetit.".

2. Ngarkohen Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për përdorimin e këtyre të ardhurave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.161, datë 18.3.2004

PËR MËNYRËN E LLOGARITJES, TË CAKTIMIT DHE PAGESËS SË PËRFITIMEVE PËR PUNONJËSIT, QË KANË PUNUAR NË DISA NDËRMARRJE TË INDUSTRISË USHTARAKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 10 e 11 të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit, që kanë punuar në ndërmarrjet e industrisë ushtarake, që përfitojnë trajtim të veçantë, më poshtë do të quhen "personi i interesuar", të dorëzojnë pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore, në vendbanimin e tyre, këto dokumente:

a) Kërkesën për përfitim (përfshirë dhe deklarimin nëse ushtron ose jo veprimtari ekonomike);

b) Certifikatën e lindjes, me fotografi;

c) Librezën e punës;

ç) Vërtetimin nga organet e tatim-taksave, se nuk ushtron veprimtari ekonomike, si person fizik ose juridik.

Personi i interesuar paraqet një kopje të kërkesës për përfitim edhe në administratën e ndërmarrjes ku ka qenë vendi i fundit i punës së tij.

2. Administrata e ndërmarrjes së industrisë ushtarake, që ka qenë vendi i fundit i punës së të interesuarit, pasi shqyrton kërkesën, plotëson këto dokumente:

a) Vërtetimin për vjetërsinë në punë, ku përfshihen periudhat e sigurimit të punës në ndërmarrjet e industrisë ushtarake dhe të gatishmërisë;

b) Vërtetimin e bazës së vlerësuar, për të cilën është derdhur kontributi i sigurimeve shoqërore, nga viti 1994 deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Këto dokumente i dërgohen Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën regjistrimin e dokumentacionit të mësipërm dhe ua dërgon drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore, ku është paraqitur kërkesa e personit të interesuar për kryerjen e procedurave të përfitimit dhe të pagesës së tij.

4. Masa e përfitimit minimal, kur mungojnë dokumentet për llogaritjen e bazës së vlerësuar për përcaktimin e përfitimit, të jetë 6728 (gjashtëmijë e shtatëqind e njëzet e tetë) lekë.

5. Efektet financiare për këtë vit fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 dhe arrijnë shumën 162 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë) lekë, e cila ndahet në zërat, si më poshtë vijon:

a) "Paga" në shumën 108 000 000 (njëqind e tetë milionë) lekë të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri "Pagesë papunësie", i miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

b) "Kontributet e sigurimeve shoqërore", në shumën 54 000 000 (pesëdhjetë e katër milionë) lekë, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Për periudhën 1 janar 2004 deri në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit, personat e interesuar të trajtohen me pagesë papunësie.

7. Punonjësit e tjerë, që nuk përfitojnë sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, të trajtohen me pagë për periudhën 1 janar 2004 deri më 31 dhjetor 2004, si më poshtë vijon:

a) Sipas vendimit nr.389, datë 8.8.2002 të Këshillit të Ministrave, gjithsej 10 punonjës të uzinës mekanike, Gramsh.

b) Sipas vendimit nr.766, datë 8.12.1998 të Këshillit të Ministrave "Për pagesën e punonjësve të disa linjave teknologjike, ushtarake, të rëndësisë së veçantë", të ndryshuar:

- 311 punonjës të kombinatit mekanik, Poliçan;
- 19 punonjës të uzinës mekanike, Gramsh;
- 20 punonjës të uzinës së lëndëve plasëse, Elbasan;
- 5 punonjës të uzinës së riparimit të aviacionit, Kuçovë;
- 20 punonjës të uzinës së pilave, Gramsh.

8. Efektet financiare, në zbatim të pikës 7 në shumën 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekë, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2004, zëri "Pagesë papunësie", miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

9. Dhënia e përfitimit të bëhet sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

10. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Ministri i Financave dhe Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.162, datë 18.3.2004

PËR PËRDORIMIN DHE KONTROLLIN E FONDIT PËR VEPRIMTARITË SPECIFIKE TË SHËRBIMIT INFORMATIV USHTARAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.9074, datë 29.5.2003 "Për Shërbimin Informativ Ushtarak", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi Informativ Ushtarak të përdorë "Fondin specifik operativ (FSO)", në lekë e valutë, që i vihet në dispozicion për realizimin e veprimtarive specifike, brenda fondeve të miratuara në buxhetin vjetor, për Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Ky fond të përdoret për:

- shpërblimin e burimeve të informacionit;
- shpenzimet për sigurimin e informacionit;
- blerjen në funksion të veprimtarive operative, me procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë";
- marrjen me qira të objekteve dhe të mjeteve, në funksion të veprimtarive operative.

3. Vlera e fondit për veprimtaritë specifike të jetë deri në 25 për qind të buxhetit vjetor të Shërbimit Informativ Ushtarak, vlerë kjo që miratohet nga Ministri i Mbrojtjes.

4. Kontrolli për shpenzimet e bëra ushtrohet, jo më pak se një herë në vit, nga personat e autorizuar nga Kryeministri.

5. Pika 12 e vendimit nr.122, datë 16.3.1992 të Këshillit të Ministrave "Për format, metodat dhe mjetet e punës të Shërbimit Informativ Ushtarak", shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.163, datë 18.3.2004

PËR KRITERET DHE MASËN E KOMPENSIMIT TË DËMEVE SHKAKTUAR PRONËS SË PUNONJËSIT TË POLICISË USHTARAKE, GJATË KRYERJES SË DETYRËS OSE PËR SHKAK TË SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 28 e 30 të ligjit nr.9069, datë 15.5.2003 "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake përfiton kompensim, sipas paragrafit të dytë të nenit 28 të ligjit nr.9069, datë 15.5.2003 "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", kur vërtetohet se:

- i është shkaktuar dëm në pasurinë e paluajtshme ose të luajtshme;
- ky dëmtim apo shkatërrim është bërë gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj;
- punonjësi i Policisë Ushtarake është pronar a bashkëpronar i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, objekt i dëmtimit;
- shkaktuesi i dëmit është dënuar, në mungesë ose është shpallur i pamundur për të shlyer detyrimin civil, me vendim gjykate të formës së prerë.

2. Kompensimi të jetë në masën 100 për qind të dëmit të shkaktuar. Ky kompensim jepet në lekë.

3. Ministri i Mbrojtjes kur mendohet për raste të dëmtimit të pronës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ngre menjëherë një grup pune për hartimin e procesverbaleve për vlerësimin e gjendjes dhe të dëmit.

4. Ministri i Mbrojtjes nxjerr urdhrin e dëmshpërblimit, pasi shqyrton procesverbalet për vlerësimin e gjendjes dhe të dëmit, administron vendimin e gjykatës për përcaktimin e shkakut të dëmtimit të pronës dhe të masës së këtij dëmtimi (nëse gjykata e ka përcaktuar këtë masë), si dhe vërtetimin e pronësisë së punonjësit të Policisë Ushtarake, të dëmtuar.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vndimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

6. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.164, datë 18.3.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË QYTETIT TË FUSHË-KRUJËS TË MJEDISEVE TË DEGËS SË MOBILIZIMIT, TË CILAT JANË NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja "c", 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e degës së mobilizimit në qytetin e Fushë-Krujës të cilat janë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, t'i kalojnë në pronësi bashkisë së këtij qyteti, për ngritjen e qendrës së trajtimit të qytetarëve pa përkrahje e të vetmuar (azil) të këtij komuniteti.
2. Prona me numër rendor 806 "Dega e mobilizimit" në Fushë-Krujë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
3. Bashkisë së qytetit të Fushë-Krujës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve, pa miratimin e pushtetit qendror.
4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Kryeregjistruesi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Fushë-Krujës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr.2, datë 18.3.2004

PËR PROCEDURAT E LËVIZJES SË OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, TË LUAJTSHME, ME VLERA TË VEÇANTA, KOMBËTARE DHE UNIKALE, PËR RUAJTJEN, RESTAURIMIN, STUDIMIN DHE EKSPOZIMIN JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Lëvizja e objekteve të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale, të përcaktuara nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore për ruajtjen, restaurimin, studimin apo ekspozimin e tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të bëhet sipas procedurave të mëposhtme:

1. Institucioni ose personi fizik ose juridik, shtetëror ose privat, i paraqet kërkesën me shkrim Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Relacionin shpjegues.

b) Arsyen e lëvizjes së këtyre objekteve.

c) Vendin ku do të çohen objektet, për arsye ekspozimi, restaurimi apo studimi.

ç) Kohëzgjatjen e qëndrimit të objekteve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe datat e nisjes e të rikthimit të objekteve në institucionin ku ruhen, ekspozohen dhe administrohen.

d) Listën e objekteve, të miratuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, të shoqëruar me pasaportën përkatëse për secilin objekt, të plotësuar nga kjo qendër.

dh) Vendimin e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, kur objektet dalin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për qëllime restaurimi.

e) Marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet institucionit apo personit juridik a fizik, privat ose shtetëror që i administron objektet dhe institucionit pritës.

ë) Policën origjinale ose të noterizuar, të primit të sigurimit të objekteve për të gjithë periudhën që ato do të jenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe për periudhën e transportit. Kjo policë duhet të jetë e klauzolës A, tipi "*all risks*", përfshi edhe transportin.

f) Marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet institucionit që administron objektet dhe institucionit, personit fizik ose juridik, shtetëror ose privat, që do të bëjë sigurimin fizik të objekteve gjatë lëvizjes së tyre, brenda dhe jashtë vendit.

3. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pas plotësimit të dokumentacionit të mësipërm, i propozon Këshillit të Ministrave projektvendimin për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale, për ruajtjen, restaurimin, studimin apo ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr.3, datë 18.3.2004

PËR FORMAT DHE PROCEDURAT E IDENTIFIKIMIT DHE TË RAPORTIMIT NGA ORGANET, QË LICENCOJNË PERSONAT FIZIKË DHE JURIDIKË, NË FUNKSION TË PROCESIT TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10/2 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Organet licencuese të kryejnë identifikimin e personave, që kërkojnë të licencohen para dhënies së licencës për të gjitha veprimet, për shuma nga 2 000 000 (dy milionë) lekë, a kundërvlerën e tyre në monedha të tjera, sipas kërkesave të nenit 4 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", të ndryshuar.

Personat fizikë dhe juridikë të identifikohen edhe në rastet kur ka të dhëna ose dyshime të bazuara në fakte e rrethana konkrete për pastrim parash, edhe për vlera financiare nën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Organet licencuese të krijojnë dosje të veçanta dhe të regjistrojnë në to të gjitha të dhënat identifikuese të personave që kërkojnë të licencohen ose që janë licencuar.

Në këtë dosje të përfshihen të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Për personin fizik, jotregtar, individ: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin e përkohshëm a të përhershëm, numrin dhe llojin e dokumentit zyrtar të identifikimit dhe organin që e ka lëshuar atë, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra në këto të dhëna, deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar.

b) Për personin juridik: emrin, numrin dhe datën e vendimit të gjykatës për regjistrimin si person juridik, numrin e lejes së ushtrimit të veprimtarisë nga organet tatimore, selinë e përkohshme a të përhershme, objektin e veprimtarisë tregtare, qëllimin, llojin, datën, shumën dhe monedhën me të cilën kryhet veprimi financiar, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra, deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar.

c) Për përfaqësuesin ligjor të klientit që do të licencohet: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, numrin e dokumentit zyrtar të identifikimit dhe lëshuesin e këtij dokumenti, aktin e përfaqësimit (prokurën), si dhe të gjitha ndryshimet e bëra në këto të dhëna, deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar.

3. Dokumentacioni i identifikimit të të gjithë personave fizikë a juridikë, që do të licencohen, të ruhet për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e përfundimit të marrëdhënieve juridike, civile me ta.

4. Organet licencuese të raportojnë tek "autoriteti përgjegjës" për çdo dyshim të bazuar, për burimin ose origjinën e kapitalit, natyrën e veprimit financiar etj., pavarësisht nga vlera e përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000, të ndryshuar, për parandalimin e pastrimit të parave, në rastet:

a) kur kanë dyshime të bazuara në fakte e rrethana konkrete, që mund të lidhen me parregullsi në dokumentacionin identifikues dhe justifikues të burimit të ligjshëm të kapitaleve me ato reale;

b) kur vërejnë parregullsi në deklarimin e burimeve të të ardhurave ose të kapitaleve, si dhe kur dyshojnë për burimet e pasurisë ose të parave të deklaruara a lidhje me veprimtari penale;

c) kur vërejnë mosjustifikim të pasurisë a të parave të deklaruara nga pikëpamja ekonomike apo ligjore;

ç) kur ka informacione, sinjalizime a të dhëna se paratë ose pasuritë e depozituara për licencimin rrjedhin nga vepra penale ose janë të përziera me para ose pasuri të tilla apo kur dyshojnë se veprimtaria, për të cilën kërkohet të licencohen, do të ngrihet për të realizuar ose mbështetur pastrimin e parave etj.;

d) kur vërejnë mosdeklarim të burimit të kapitalit ose të të ardhurave;

e) kur kanë dyshime të tjera, të bazuara në gjendjen ose rrethanat, të cilat nuk janë parashikuar më lart.

Për çdo rast dyshimi, raportimi të bëhet sipas aneksit 1 "Formulari i sinjalizimit për persona që licencohen", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

5. Organet licencuese të raportojnë tek "autoriteti përgjegjës" për personat që paraqesin kërkesën për licencim, përpara dhënies së licencës për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, për çdo veprim financiar mbi 20 000 000 (njëzet milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera, sipas aneksit 2 "Formulari i veprimeve financiare për personat fizikë dhe juridikë, që licencohen", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

6. Organet licencuese të kërkojnë deklarimin e burimit të ligjshëm të kapitaleve dhe sqarime të mëtejshme për paqartësi rreth identifikimit të personit fizik ose juridik, administratorit, ortakëve dhe burimeve, si dhe të bëjnë verifikime për kapitalin fillestar të personave fizikë a juridikë, për të qartësuar burimin e krijimit të këtij kapitali për ushtrimin e veprimtarisë.

7. Organet licencuese të raportojnë tek "autoriteti përgjegjës", menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për të gjitha rastet e parashikuara më sipër, si dhe për çdo të dhënë tjetër, që vërteton ose kundërshton, të dhënat e bazuara në fakte ose rrethana konkrete a dyshime për pastrim parash, me faks, e-mail, telefon, korrier, duke e shoqëruar me një raport zyrtar, me shkrim.

8. Organet licencuese të njoftojnë "autoritetin përgjegjës" në të njëjtën mënyrë, në çdo rast kur kanë të dhëna ose dyshime për implikime ose qëllime, që veprimtaria do të përdoret për të mbështetur, lehtësuar, ruajtur, nxitur ose fshehur akte terroriste apo do të financojë terrorizmin.

9. Organet licencuese të caktojnë një drejtues të nivelit të lartë, tek i cili nëpunësit dhe punonjësit, që merren me procesin e licencimit, të raportojnë të dhëna të mjaftueshme, që mund të shërbejnë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 5 të ligjit, për parandalimin e pastrimit të parave.

10. Organet licencuese të sigurojnë krijimin e një qendre për grumbullin e të dhënave për parandalimin e pastrimit të parave, sipas detyrimit të nenit 7 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000.

11. Organet licencuese të hartojnë programe kontrolli për testimin e sistemit dhe të bashkëpunojnë me organet e kontrollit të brendshëm të institucionit, për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

12. Organet licencuese t'i dërgojnë "autoritetit përgjegjës", në afatet e përcaktuara, të dhënat shtesë dhe dokumentet e kërkuara. Kur ka arsye të bazuara se afati i caktuar është i pamjaftueshëm, kërkohet zgjatja e tij, por jo më shumë se 15 ditë nga marrja e kërkesës.

13. Në përputhje me detyrimet përkatëse ligjore dhe sipas fushës së veprimtarisë, organet licencuese të përgatisin dhe të zbatojnë rregullore dhe udhëzime të brendshme, për të vlerësuar dhe identifikuar transaksionet e lidhura me veprimtari të paligjshme.

14. Organet licencuese të marrin masat përkatëse për të njoftuar në mënyrë periodike, punonjësit, për procedurat ligjore të veprës penale të pastrimit të parave, si dhe për hartimin e programeve të trajnimit dhe të kualifikimit të personelit.

15. Organet licencuese, që përcaktohen në nenin 10/2 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000, të ndryshuar dhe punonjësit e drejtuesit e çdo niveli, që ngarkohen me raportimin e transaksioneve të dyshimta, në zbatim të nenit 6 të ligjit, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe ndalohen të njoftojnë subjektet që do të licencohen, për procedurat e verifikimit, dyshimet dhe për çdo të dhënë tjetër për pastrimin e parave.

16. Organet licencuese detyrohen t'i mbajnë dhe t'i ruajnë raportimet për veprimin financiar të subjektit që do të licencohet, për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e kryerjes së veprimit financiar.

17. Organet licencuese, në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000, të ndryshuar, janë të detyruara të zbatojnë urdhrat e "autoritetit përgjegjës" për bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit a të veprimit financiar, për një periudhë jo më tepër se 72 orë, në rastet e licencimit, kur subjekti që licencohet kryen pagesën e kapitalit themeltar ose shtimin e kapitalit.

18. Ngarkohen "autoriteti përgjegjës", organet që licencojnë personat fizikë dhe juridikë dhe institucionet nga të cilat varen këto organe për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.5, datë 11.3.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i	" "
Gjergj Sauli	Anëtar i	" "
Kristofor Peçi	Anëtar i	" "
Kujtim Puto	Anëtar i	" "
Petrit Plloçi	Anëtar i	" "
Sokol Sadushi	Anëtar i	" "
Alfred Karamuço	Anëtar i	" "

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 9.3.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.8 Akti që i përket:

KËRKUES: GJIN GJONI, përfaqësuar nga avokat Fatmir Gjika.
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, përfaqësuar nga zëvendëskryetari, zoti Ilir Panda, me autorizim.
2. KONFERENCA KOMBËTARE GJYQËSORE, në mungesë.
OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.151/1, datë 31.1.2004 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kërkuesi ka parashtruar se vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor në këto drejtime:
- Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka të drejtë të heqë mandatin e dhënë nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare;
- Në votim, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë janë përjashtuar katër anëtarët e rinj;
- Nuk është dëgjuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë kur është marrë vendimi;
- Janë përdorur dy standarde nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë lidhur me stazhin e ndihmësgjyqtarit të emëruar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, kërkuesin e përfaqësuesin e tij, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë në datën 31.1.2004, në zbatim të neneve 9 e 10 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", ka proceduar në verifikimin e mandateve të 5 (pesë) anëtarëve të rinj të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Në përfundim, me vendimin nr.151/1, datë 31.1.2004, Këshilli i Lartë i Drejtësisë konstaton se katër anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë zgjedhur në përputhje me ligjin, ndërsa përsa i përket kërkuesit, është konstatuar dhe çmuar se zgjedhja e tij është bërë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi i parë i ligjit të lartpërmendur, për arsye se ai ka ushtruar detyrën e gjyqtarit për më pak se 10 (dhjetë) vjet. Ndërkohë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë i ka kërkuar Konferencës Gjyqësore Kombëtare zhvillimin e zgjedhjeve të reja.

Në shqyrtimin e kësaj çështjeje, Gjykata Kushtetuese i referohet para së gjithash përmbajtjes e kuptimit të dispozitave kushtetuese, e veçanërisht nenit 147 të Kushtetutës, si dhe dispozitave të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë". Duke shqyrtuar raportet kushtetuese e ligjore midis Konferencës Gjyqësore Kombëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka në rastin e dhënë, në kuptim të nenit 10 të ligjit, vetëm të drejtën e pezullimit të ushtrimit të mandatit dhe të kërkimit të zgjedhjeve të reja.

Në këto kushte, kur vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk është përfundimtar, lidhur me të drejtën e kërkuesit për të qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese e gjen kërkesën e paraqitur jashtë juridiksionit të saj të përcaktuar nga dispozitat kushtetuese. Edhe pse kërkesa është drejtuar për një proces të parregullt ligjor, përderisa ajo është e lidhur pazgjidhshmërisht me aktin objekt konflikti kushtetues, është e domosdoshme që ai të jetë përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në neneve 131 e 134 të Kushtetutës, si dhe në neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr.6, datë 30.4.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i	" "
Gjergj Sauli	Anëtar i	" "
Kristofor Peçi	Anëtar i	" "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	" "
Petrit Plloçi	Anëtar i	" "
Sokol Sadushi	Anëtar i	" "
Alfred Karamuço	Anëtar i	" "

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 19.2.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.6 Akti që i përket:

KËRKUES: FERDINAND CENJA, përfaqësuar nga avokat Arben Hakani, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zoti Skënder Breca, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr.326, datë 18.4.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr.90, datë 27.9.2001 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe nr.106, datë 8.2.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).

Kërkuesi parashtron se vendimet e atakuara janë rezultat i një procesi të parregullt gjyqësor, në këto drejtime:

- Nuk është realizuar e drejta e mbrojtjes, duke u caktuar një avokat i cili ka vepruar në kundërshtim me interesat e kërkuesit, sepse në ankim dhe rekurs ka kërkuar dënim më të rëndë nga sa ka caktuar gjykata e rrethit;

- Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk kanë respektuar parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, sepse megjithëse janë vënë në lëvizje nga mbrojtësi, kanë ndryshuar cilësimin juridik të veprës dhe të dënimit në disfavor të kërkuesit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.2821, datë 14.9.1999 të Gjykatës së Apelit të Athinës, Ferdinand Cenja, është shpallur fajtor për transport lëndësh narkotike dhe është dënuar me 18 vjet burgim.

Me kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme (pasi janë kryer procedurat paraprake), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr.61, datë 6.1.2000, ka njohur vendimin e gjykatës greke dhe duke bërë konvertimin, i ka caktuar kërkuesit një dënim prej 5 vjetësh burgim. Sipas gjykatës, i pandehuri është dënuar nga gjykata greke, sepse po transportonte një sasi bime *canabis ativa* të papërpunuar e për pasojë, vepra e tij nga legjislacioni shqiptar kualifikohej sipas nenit 285 të Kodit Penal.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim mbrojtësi i të pandehurit, i caktuar kryesisht nga gjykata, i cili ka arsyetuar se ligji është zbatuar gabim dhe ka kërkuar që i mbrojturi prej tij të dënohej me 15 vjet burg, mjafton që ai ta vuante dënimin në Shqipëri.

Gjykata e Apelit Gjirokastër ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm. Avokati, me të njëjtat argumente, ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr.326, datë 23.4.2001, ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe e ka kthyer çështjen për t'u gjykuar po nga ajo gjykatë. Në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pranohet që canabis sativa është lëndë narkotike dhe jo substancë që përdoret për prodhimin e saj, si dhe fakti që, në rastin konkret, ka konvertim të dënimit të një autoriteti gjyqësor të huaj dhe nuk mund të bëhet fjalë për rëndim të pozitës së të pandehurit (neni 425 i Kodit të Procedurës Penale).

Mbi bazën e këtij vendimi, Gjykata e Apelit Gjirokastër ka rishqyrtuar çështjen dhe ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë duke caktuar një dënim prej 13 vjetësh burg.

Kundër këtij vendimi është bërë rekurs nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, duke parashtruar se është zbatuar gabim ligji material dhe se është rënduar pozita e të pandehurit. Kolegji Penal (në Dhomën e Këshillimit) me vendimin nr.108, datë 8.2.2002, ka vendosur moskalimin për shqyrtim të rekursit.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke shqyrtuar çështjen në përputhje me dispozitat kushtetuese, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën Europiane "Për transferimin e personave të dënuar" ratifikuar me ligjin nr.8499, datë 10.6.1999, Konventën midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë të 17 majit 1993 "Për zbatimin reciprok të vendimeve gjyqësore për çështjet penale", si dhe me nenet 512-516 të Kodit të Procedurës Penale, arrin në konkluzionin se kërkesa duhet pranuar. Vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.326, datë 18.4.2001, Gjykatës së Apelit Gjirokastër nr.90, datë 27.9.2001, si dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) nr.106, datë 8.2.3003, janë rezultat i një procesi të parregullt gjyqësor e kryesisht në drejtim të mbrojtjes e garantimit të të drejtave të dënuarit.

Transferimi i personave të dënuar është rezultat i marrëdhënieve dypalëshe e shumëpalëshe në fushën e drejtësisë dhe ka për qëllim rehabilitimin shoqëror të personave të dënuar nëpërmjet krijimit të mundësive për vuajtjen e dënimit në vendet e tyre. Transferimi, sipas akteve të

përmendura më lart, mundësohet nëpërmjet procedurave paraprake administrative, të cilat realizohen nga Ministria e Drejtësisë, si dhe procedurave gjyqësore të inicuara nga organi i prokurorisë.

Nëpërmjet procedurave gjyqësore realizohet njohja e vendimeve penale të gjykatave të huaja, si dhe caktohet dënimi që do të vuajë i dënuari në shtetin pritës.

Duke shqyrtuar përmbajtjen e konventave dhe të dispozitave procedurale penale, del se procedurat e mësipërme nuk përbëjnë shqyrtimin në themel të çështjes, por një shqyrtim gjyqësor të veçantë, ku duhet të zbatohen një sërë principesh themelore të gjykimit.

Në këtë fazë, gjykata shqyrton nëse ekzistojnë ose jo kushtet e njohjes, parashikuar nga neni 514 i Kodit të Procedurës Penale, cakton dënimin që duhet të vuhet në përputhje me legjislacionin shqiptar për të njëjtin fakt të pranuar nga gjykata e huaj, duke zbatuar edhe kriteret e përcaktuara nga neni 11 i Konventës Europiane, neni 8 i Konventës dypalëshe, si dhe neni 516 i Kodit të Procedurës Penale.

Nisur nga karakteristikat e këtij procesi, si dhe nga prezenca në këtë proces e prokurorit, bëhet imperative sigurimi e garantimi i mbrojtjes së të dënuarit. I dënuari që është duke vuajtur dënimin me burgim në një shtet të huaj, për shkak se e ka të pamundur paraqitjen në gjykatën shqiptare ka të drejtë të caktojë një avokat vetë personalisht dhe nëse ai nuk e realizon një mundësi të tillë është gjykata e detyruar të caktojë një mbrojtës kryesisht. Ashtu si dhe në çdo çështje gjyqësore edhe në këtë lloj procesi, avokati është i detyruar të respektojë ligjin, rregullat e etikës profesionale, me qëllim që të mbrojë me mjete ligjore të drejtat e të mbrojturit prej tij.

Ashtu siç doli nga gjykimi, avokati i kërkuesit i caktuar nga gjykata, pa dijeni e miratim të kërkuesit ka kërkuar qysh në procesin e njohjes në gjykatën e rrethit ashtu dhe në ankim e në rekurs aplikimin e dispozitave ligjore dhe e dënimit në disfavor me interesat e kërkuesit. Gjykata e Apelit Gjirokastër e Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë janë vënë në lëvizje e kanë pranuar kërkimet e avokatit, të cilat janë bërë tej tagrave të tij ligjore e etike. Në këto kushte, avokati ka vepruar në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrimeve të tij, ndërsa gjykatat kanë zhvilluar një proces të parregullt gjyqësor, në kundërshtim me nenin 42/1 të Kushtetutës.

Duke pranuar zhvillimin e një procedure gjyqësore të veçantë Gjykata Kushtetuese vlerëson se në zhvillimin e saj duhet të respektohen një sërë të drejtash të garantuara nga Kushtetuta e ligji procedural penal e sidomos e drejta e mbrojtjes. Por, e drejta e mbrojtjes nuk mund të kuptohet pa garancitë reale që e bëjnë atë të realizueshme, ndër të cilat mosrëndimi i pozitës së të pandehurit zë një vend të rëndësishëm e merr dimension kushtetues.

Në kundërshtim me sa u arsyetua më lart, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ashtu dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër, në gjykimet e tyre kanë mënjanuar këtë garanci, duke arsyetuar në vendime, se parimi i mësipërm nuk mund të zbatohet në fazën e procedurave gjyqësore që lidhen me ekzekutimin. Edhe në këtë aspekt, këto vendime janë rezultat i procesit të parregullt gjyqësor në kuptimin kushtetues.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues nr.5, datë 10.10.2002, u kanë dhënë zgjidhje disa problemeve të konstatuara në vendimet gjyqësore të mësipërme, objekt shqyrtimi nga ana jonë.

Kështu, në vendimin unifikues pranohet se gjykimi për njohjen e vendimit penal dhe konvertimin e dënimit të huaj, edhe pse nuk është gjykim themeli është një gjykim i posaçëm (sui generis); se vendimi i dhënë pavarësisht nga natyra e tij është një vendim gjyqësor ndaj të cilit, sipas Kushtetutës, kushdo ka të drejtë të ankohet në një gjykatë më të lartë. Në vendim, lidhur ngushtë me çështjen në shqyrtim, pranohet zbatimi i nenit 425 të Kodit të Procedurës Penale (mosrëndimi i pozitës së të pandehurit).

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në neneve 131 e 134 të Kushtetutës, si dhe në neneve 26/1 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr.326, datë 18.4.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr.90, datë 27.9.2001 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe nr.106, datë 8.2.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Në çështjen me kërkues Ferdinand Cenja, kemi mendimin se trajtimi i problemit dhe konkluzionet që arrihen në vendimin e shumicës nuk janë të drejta. Pretendimet e ngritura për proces të parregullt në kuptimin kushtetues duhej të ishin rrëzuar për këto arsye:

1. Në bazë të parimit të njohur të veprimit të ligjit penal në hapësirë, me vendimin nr.2821, datë 14.9.1999, kërkuesi (shtetas shqiptar) është dënuar nga Gjykata e Apelit Athinë me 18 vjet burg nën akuzën e importimit, posedimit dhe transportimit në bashkëpunim të lëndës narkotike, pasi më 13.5.1998, së bashku me 4 persona të tjerë, po nga Shqipëria, ishte kapur në flagrancë nga policia greke duke transportuar me furgon në drejtim të Athinës 322 kg e 615 gram *canabis ativa* të papërpunuar. Brenda afateve ligjore të parashikuara nga legjislacioni grek, vendimi në fjalë ka marrë formë të prerë. Prandaj, bazuar në parimin e mirënjohur në *bis in idem*, ndaj kërkuesit nuk kanë qenë kushtet për të filluar çështje penale sipas ligjit penal shqiptar, në bazë të paragrafit të dytë të nenit 6 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

2. Bashkëpunimi edhe në çështjet penale është sot një veçori pozitive bashkëkohore, që karakterizon marrëdhëniet ndërmjet shteteve në rajone të ndryshme të botës. Një gjë e tillë diktohet nga hapja e kufijve, zgjerimi i lirisë së individit, nevojës për të ndërtuar shtetin e së drejtës dhe përpjekjeve për të luftuar me sa më shumë efikasitet kriminalitetin në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Në këtë kuadër dhe me këtë synim, parashikohet edhe bashkëpunimi i shteteve në ekzekutimin e vendimeve të huaja penale, që do të thotë transferimi i personave të dënuar penalisht nga territori i shtetit dënues në territorin e shtetit zbatues, i cili si rregull është shteti, shtetësinë e të cilit mban personi i dënuar. Pra, bëhet fjalë për vazhdimin e zbatimit (vuajtjes) në kushte të reja të një vendimi penal të formës së prerë të dhënë më parë nga shteti dënues. Kjo problematikë rregullohet nga një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare shumëpalëshe e dypalëshe, mes të cilave do të veçonim Konventën e Këshillit të Europës "Për transferimin e personave të dënuar" të vitit 1983, ratifikuar edhe nga vendi ynë me ligjin nr.8499, datë 10.6.1999. Sipas kësaj Konvente, transferimi i personave të dënuar penalisht mund të bëhet në dy mënyra: a) të menjëhershme apo të drejtpërdrejtë, duke njohur të plotë në shtetin zbatues vendimin penal konkret të dhënë në shtetin dënues dhe b) duke bërë konvertimin e këtij dënimi përmes një vendimi gjyqësor ose administrativ që duhet të merret për këtë qëllim nga autoritetet kompetente të vendit zbatues. Por në këtë rast, ndër të tjera, është mëse e domosdoshme të respektohen veçanërisht dy kërkesa: aa) që konvertimi të bëhet "me një sanksion … për të njëjtën vepër penale" me të cilën është dënuar nga shteti dënues (neni 9/1/b i Konventës së KE) dhe bb) vendimi i konvertimit duhet "t'i përmbahet natyrës ligjore dhe kohëzgjatjes së dënimit" të dhënë nga shteti dënues (neni 10/1 i Konventës së KE-së). Përveç kësaj, në asnjë rast Konventa nuk lejon që përmes vendimit konvertues të rëndohet pozita (dënimi) i personit të dënuar (neni 11/d i Konventës së KE-së).

Pasi ka marrë formë të prerë, vendimi i konvertimit i dërgohet në rrugë diplomatike (si rregull) shtetit dënues, i cili natyrisht që ka në dorë të gjykojë mbi bazueshmërinë në Konventë të këtij vendimi. Mbi këtë bazë, pasi të ketë njohur normalisht edhe personin e interesuar me këtë vendim, në mënyrë diskrecionare shteti dënues vendos përfundimisht për transferimin ose jo të tij në shtetin zbatues.

Vendi ynë njeh mënyrën e dytë të transferimit të personave të dënuar penalisht, duke parashikuar konvertimin në rrugë gjyqësore të vendimit të dhënë nga shteti dënues, por natyrisht duke respektuar kërkesat dhe standardet e Konventës së sipërcituar. Kjo pasqyrohet jo vetëm nga dispozitat respektive të Kodit të Procedurës Penale (nenet 512–518), por edhe nga Konventa dypalëshe midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë "Për transferimin e të dënuarve të burgosur" , nënshkruar në Athinë, më 17 maj 1993. Të dy këto dokumente rezultojnë të kenë pasur parasysh pothuajse në të gjitha elementet themelore Konventën e Këshillit të Evropës të përmendur më sipër. Megjithatë, edhe në rast vakumi apo papajtueshmërie të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale me këto dy Konventa, është mëse e qartë që, bazuar në nenet 116/1 dhe 122/1;2 të Kushtetutës, normat e këtyre dy të fundit kanë zbatim të drejtpërdrejtë dhe përparësi mbi ligjet e vendit që mund të mos pajtohen me ato.

3. Pra, gjykimi për konvertimin e një dënimi të huaj penal është një gjykim sui generis, një gjykim ekstra procedural krejt i veçantë. Gjykatat thjesht konvertojnë një vendim penal të formës së prerë të dhënë më parë nga një gjykatë e huaj, me efektin e vetëm që i dënuari të vuajë dënimin e mbetur në shtetin e tij, pasi kështu mund të bëhet më mirë dhe më shpejt riasocimi i tij, si dhe evitohen problemet apo ngarkesat shtesë që vijnë për shkak të komunikimit (gjuhës), ushqimit, rrethit kulturor, vështirësive apo humbjes së kontaktit me familjarët etj. Në këtë gjykim, gjykatat respektojnë rigorozisht faktet dhe konkluzionet e vendimit të dhënë në shtetin dënues, dhe duke iu referuar së njëjtës figurë të veprës penale të parashikuar tashmë në Kodin Penal të shtetit zbatues (nëse në këtë Kod nuk është parashikuar një figurë e tillë identike e veprës penale, sipas dy konventave dhe Kodit të Procedurës Penale, nuk mund të fillojnë procedurat e konvertimit të vendimit të huaj penal), japin një sanksion që duhet "t'i përmbahet natyrës ligjore dhe kohëzgjatjes së dënimit" të dhënë më parë. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vënë në dukje mëse një herë se "vendimi i gjykatës shqiptare që bën konvertimin nuk është një vendim i ri dhe se gjykata shqiptare nuk e shqyrton çështjen në themel dhe as nuk verifikon provat e marra nga gjykata e shtetit dënues". Pra, vendimi i gjykatës shqiptare nuk rivlerëson vendimin e huaj penal, ajo nuk trajton rrethanat e çështjes, bazueshmërinë në fakte dhe në ligj apo rrethanat rënduese e lehtësuese të zbatuara për marrjen e vendimit në fjalë, sepse ndryshe do të kishim një gjykim të ri. Në gjykimin për konvertimin e dënimit të huaj penal, objekti dhe kufijtë e shqyrtimit janë tepër të kufizuar dhe krejt të ndryshëm nga procesi kryesor. Gjykata shqiptare vetëm kontrollon praninë ose jo të kushteve juridiko–formale për njohjen e vendimit të huaj penal (vendimi i huaj ka marrë formë të prerë, vepra parashikohet si e dënueshme edhe nga legjislacioni shqiptar, është marrë pëlqimi paraprak për transferim i personit të dënuar etj.), dhe më pas në bazë të kritereve rigorozisht të caktuara që u përmendën më lart, konverton dënimin e dhënë në shtetin e huaj me një sanksion të parashikuar për të njëjtën vepër nga ligji penal shqiptar.

4. Me të drejtë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.326, datë 23.04.2001, ka prishur vendimin nr.109, datë 12.12.2000 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër që linte në fuqi vendimin nr.61, datë 6.10.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke arsyetuar ndër të tjera se ato kanë zbatuar gabim kërkesat e ligjit nr.7975, datë 26.7.1995 "Për barnat narkotike e lëndët psikotrope", tabela nr.1 sipas Konventës Europiane të vitit 1961, duke mos e konsideruar *canabis ativën* si lëndë narkotike, ashtu siç ka vepruar edhe Gjykata e Apelit Athinë, por si substancë që përdoret për krijimin e lëndës narkotike. Mbi këtë bazë, me vendimet e mësipërme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe ajo e Apelit Gjirokastër kanë bërë gabim konvertimin e dënimit me nenin 285 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, duke caktuar dënimin me 5 vjet burg (dënimi maksimal), në vend që ta konvertonin dënimin me nenin 283 të këtij Kodi. Eshtë mëse e qartë se në këtë mënyrë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër në gjykimin për konvertimin e dënimit të huaj penal, kanë vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 516/1 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe me kërkesat e neneve 9/1/b dhe 10/1 të Konventës së Këshillit të Europës "Për transferimin e personave të dënuar". Ato nuk kanë pasur parasysh as kërkesën për kualifikimin ligjor të veprës penale, ashtu siç është bërë edhe nga Gjykata e Apelit Athinë, e për rrjedhojë as kërkesën mbi kohëzgjatjen e dënimit konvertues.

5. Në çdo rast, brenda kuadrit ligjor dhe objektit të punës, avokati ka për detyrë të mbrojë interesat e klientit të tij. Kjo është një nga kërkesat themelore të etikës profesionale të avokatit. Nga ana tjetër, ndihma e avokatit, siç ka theksuar mëse një herë edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, duhet të jetë "praktike dhe efikase dhe jo vetëm teorike dhe iluzore".

Në kundërshtim me pretendimet e kërkuesit dhe konkluzionet e shumicës, ne mendojmë se ankimi dhe rekursi i bërë nga avokati i caktuar kryesisht ndaj vendimeve nr.61, datë 06.01.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe nr.109, datë 12.12.2000 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, përmes të cilave është kërkuar rikualifikimi ligjor i veprës në bazë të nenit 283 të Kodit Penal dhe dënimi i kërkuesit me 15 vjet burg, nuk kanë cenuar të drejtën e mbrojtjes, përkundrazi janë në përputhje të plotë me detyrën e ushtruar në këtë proces dhe në interes të klientit të përfaqësuar. Në fund të fundit, objektivi kryesor i punës së avokatit ka qenë zhvillimi i një gjykimi për konvertimin e dënimit të huaj penal në mënyrë të tillë që të bëhet e mundur transferimi i personit të dënuar në atdheun e tij. Pikërisht për këtë arsye dhe brenda objektit dhe kufijve të shqyrtimit të çështjes në gjykimet konvertuese, avokati është i interesuar të zbatohen kërkesat themelore të konventave të përmendura më sipër, si dhe legjislacioni përkatës i vendit tonë. Vetëm kështu ekzistojnë mundësitë që autoritetet përkatëse të shtetit dënues të japin pëlqimin e tyre përfundimtar dhe të lejojnë transferimin e personit të dënuar për të vazhduar vuajtjen e dënimit në shtetin e tij. Sigurisht që brenda kësaj hapësire ligjore që lejon procesi i konvertimit të dënimit, gjithnjë në interes të klientit të tij, avokati mund të kërkojë edhe uljen e dënimit të dhënë më parë, gjë që praktikisht është bërë në këtë proces (nga 18 vjet burg që është dënimi i formës së prerë i gjykatës greke, avokati në gjykimin konvertues ka kërkuar 15 vjet). Por ai (avokati) nuk mund të heshtë ndaj shkeljeve flagrante të kërkesave themelore në gjykimin për konvertimin e dënimit të huaj penal, sepse ishte i bindur që kualifikimi i gabuar ligjor i veprës penale (krejt i ndryshëm nga ai i vendimit përfundimtar të gjykatës greke), dhe për rrjedhojë diferenca e theksuar në masën e dënimit (nga 18 vjet në 5 vjet burg), do të çonin në mosmiratimin përfundimtar nga ana e organeve kompetente greke të këtij vendimi e për rrjedhojë edhe mosrealizimi i qëllimit kryesor të procesit konvertues, që ishte kthimi i klientit të tij për të vazhduar vuajtjen e dënimit për të njëjtën vepër penale në Shqipëri. Ky qëllim dhe ky motiv i avokatit del fare qartë në kërkesën ankimore dhe në rekursin që ai u ka paraqitur respektivisht Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë, ku thekson ndër të tjera se "… për oportunitet të ligjit mund të themi se është një rast tepër i veçantë që një shtetas shqiptar kërkon nga gjykata e vendit të tij që të aplikojë ndaj tij një dënim tepër më të rëndë, plot 15 vjet burg, me të vetmin kusht që këto vite të gjata burgu t'i vuajë pranë familjes, në Atdheun e tij dhe gjykata shqiptare nuk e lejon të vuajë dënimin në Atdheun e tij".

6. Ndalimi *reformatio in peius* apo i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, përbën padyshim një element të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Ai është një garaci me vlerë për dhënien e drejtësisë dhe ushtrimin në mënyrë efektive të së drejtës së ankimit nga ana e të pandehurit. Mbi këtë çështje është shprehur disa herë edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe ajo e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Megjithatë, në rastin konkret duhet pasur mirë parasysh se nuk kemi të bëjmë me person të pandehur, por person të dënuar dhe të burgosur me një vendim të huaj penal të formës së prerë, i cili duhet të konvertohet vetëm për efekte të zbatimit të mëtejshëm të tij në territorin shqiptar, por duke respektuar rigorozisht kriteret e përcaktuara në konventat ndërkombëtare dhe legjislacionin e vendit tonë. Për këtë arsye, në këtë proces nuk ka vend të zbatohen garancitë për mosrëndim të pozitës së të pandehurit, parashikuar edhe nga neni 425/3 i Kodit të Procedurës Penale. Garancia për mosrëndimin e dënimit të kërkuesit parashikohet nga vetë dy konventat e mësipërme, por gjithnjë duke respektuar kriteret themelore të konvertimit dhe duke marrë si pikë referimi masën e dënimit përfundimtar të dhënë nga gjykata e shtetit dënues (shih nenin 11/d të Konventës së Këshillit të Europës dhe nenin 9/3 të Konventës "Për transferimin e të dënuarve të burgosur" ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë). Nga ana tjetër, me të drejtë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr.5, datë 10.10.2002, bazuar në nenin 43 të Kushtetutës, kanë theksuar ndër të tjera se e drejta e ankimit nuk mund t'u mohohet të dënuarit dhe prokurorit edhe në gjykimet për konvertimin e dënimit të huaj penal, pavarësisht se kemi të bëjmë me një gjykim krejt të veçantë dhe jo me gjykim themeli. Por kjo e drejtë duhet ushtruar në përputhje me objektin e gjykimit për konvertim të

dënimit, kufijtë e shqyrtimit të çështjes, kriteret ligjore dhe interesin themelor apo të drejtpërdrejtë të personit të dënuar, që është vazhdimi i vuajtjes në atdhe të një vendimi të huaj penal të formës së prerë. Në këtë kuptim, bazuar në rekursin e paraqitur nga avokati, në vendimin nr.326, datë 18.4.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë jo vetëm që nuk ka elemente të procesit të parregullt në kuptimin kushtetues, por përkundrazi kanë qenë orientimet e dhëna në këtë vendim në bazë të nenit 434 të Kodit të Procedurës Penale, që e kanë futur gjykimin për konvertimin e dënimit në linjën e vet normale dhe ligjore. Pikërisht mbi këtë bazë është dhënë vendimi nr.90, datë 27.9.2001 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, që e konverton dënimin e dhënë me 18 vjet burg nga Gjykata e Apelit Athinë me një dënim prej 13 vjetësh burg, bazuar tashmë në nenin 283 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, duke iu përmbajtur kështu orientimeve të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe arsyetimit e kualifikimit ligjor të veprës penale të bërë nga gjykata greke. Rekursi i paraqitur nga prokurori ndaj vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Gjirokastër është refuzuar me të drejtë me vendimin nr.106, datë 8.2.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, marrë në Dhomën e Këshillimit. Në këtë mënyrë janë ezauruar të gjitha rrugët normale ligjore për shqyrtimin e çështjes së konvertimit të dënimit të huaj penal dhe vendimet e mësipërme iu janë bërë të njohura në rrugë diplomatike (Ministria e Drejtësisë) autoriteteve kompetente greke. Ato i kanë miratuar këto vendime si të drejta, normalisht kanë vënë në dijeni kërkuesin (personin e dënuar), i cili, përderisa nuk provohet e kundërta, ka dhënë përfundimisht pëlqimin e tij dhe mbi këtë bazë, në dhjetor të vitit 2002 (pra, pas rreth 8 muajsh nga vendimi përfundimtar dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë) është bërë transferimi për vazhdimin e vuajtjes së dënimit të huaj penal në Shqipëri.

7. Së fundi ritheksojmë se edhe pas konvertimit të vendimit të huaj penal, nga pikëpamja juridiko–formale, i dënuari vazhdon të konsiderohet si person i dënuar nga shteti në territorin e të cilit është kryer vepra penale. Për këtë arsye, vetëm shteti dënues ka të drejtë të shqyrtojë dhe vendosë përfundimisht edhe për pretendimet apo kërkesat e mundshme për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë të dhënë më parë po nga ky shtet (neni 13 i Konventës së Këshillit të Europës dhe neni 13 i Konventës "Për transferimin e të dënuarve të burgosur". Për më tepër, shteti zbatues është i detyruar të informojë në vazhdimësi shtetin dënues, lidhur me ekzekutimin në vijimësi të vendimit tashmë të konvertuar, sa herë që shteti dënues e kërkon një gjë të tillë ose kur merren vendime apo vërtetohen rrethana mbi bazën e të cilave ekzekutimi i dënimit konsiderohet tërësisht ose pjesërisht i përfunduar (nenet 15 dhe 14 të dy konventave të mësipërme). Mbi këtë bazë, bazuar në parimin e njohur *rebus sic stantibus*, marrja e një vendimi të ri konvertues mund të bëhej shkak për rikonsiderimin tërësor të procedurave të transferimit të personit të dënuar.

Sigurisht që mund të jetë rasti për të ngritur çështjen e aplikimit të dënimeve të ashpra ndaj shtetasve të shtetit zbatues, si rezultat i politikave të caktuara penale të shtetit dënues. Megjithatë, probleme të tilla mund të diskutohen e zgjidhen në parim në rrugë diplomatike dhe jo gjyqësore. Nga ana tjetër, nëse është rasti, çështje konkrete mund t'i paraqiten për gjykim edhe Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Anëtarë: Gj. Sauli, Xh.Zaganjori, P. Plloçi

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit gjyqësor Berat në bazë të nenit 10 të Kodit Civil dhe neneve 382/2 e 384 të Kodit të Procedurës Penale, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Aida Shehu dhe caktimin e një kujdestari të përkohshëm.

KËRKESË

Shtetësja Vilma Kosturi kërkon shpalljen të vdekur të babait të saj, Viliam Kosturi.

KËRKUESE
Vilma Kosturi

KËRKESË

Shtetësja Bukuroshe Qorri kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, Jani Qorri.

KËRKUESE
Bukuroshe Qorri

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
  Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 31.3.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë